



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

**Plani Vjetor i Punës
i Zyrës Kombëtare të Auditimit**

**për sezonin e auditimit 2017/18
(1 shtator 2017 deri më 31 gusht 2018)**

Prishtinë, gusht 2017

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Objektivat e ZKA-së	5
3. Llojet e auditimeve	7
4. Procesi i auditimit	8
5. Plani Vjetor i Auditimit dhe organizimi	9
6. Buxheti dhe burimet njerëzore	16
7. Bashkëpunimi dhe projektet	18
8. Zbatimi	20

1. HYRJE

Ky dokument paraqet Planin Vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit (“ZKA”), i cili përfshinë të gjitha aktivitetet e ZKA-së dhe Planin e Auditimit për sezonin auditues 2017/18, sipas Nenit 20 të Ligjit Nr.05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (“Ligji i ZKA-së”), i cili dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit, deri më 31 tetor.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë në konsideratë, përbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjërë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë dhe aktualitetin e çështjeve të caktuara dhe adresimi i kërkeseve specifike të Kuvendit dhe të palëve të tjera të interesit, si donatorët, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe burimet njerëzore dhe financiare që ka në disponim ZKA.

Zyra Kombëtare e Auditimit si Institucion Suprem i Auditimit (“ISA”) kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm përcaktohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin e ZKA-së.

ZKA auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA poashtu kryen auditime të përformancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe ofrimit të tyre me kosto efektive.

ZKA është e dedikuar që të ofrojë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, të ndihmoj entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit finansiar dhe kontrollit përmes rekomandimeve praktike dhe konstruktive, si dhe t'i shtojë vlerë veprimtarive të tyre operative dhe strategjike. Rezultatet e punës së ZKA-së kanë për qëllim të rrisin besueshmërinë në shpenzimin e fondeve publike.

ZKA do të luaj një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit përmes rritjes së llogaridhënieve publike. Raportet e ZKA-së përbajnë rekomandime për adresimin e dobësive të identifikuara. Duke e bërë këtë, ne duam t'i ofrojmë Kuvendit, Qeverisë, dhe taksapaguesve një shërbim profesional dhe të integruar të auditimit.

Raportet e ZKA-së, përfshirë edhe Raportin Vjetor të Auditimit, promovojnë llogaridhënie ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve publike në nivel institucional përmes shqyrtimit të raporteve individuale të auditimit nga Kuvendi dhe Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike. Auditimet ndërmerrin në pajtueshmëri me standarde e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik (“SNISA”) duke u bazuar në llogaridhënie, kompetencë, përsosmëri profesionale, pavarësi dhe objektivitet. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për publikun dhe publikohen në faqen e internetit të ZKA-së.

1.1 Përkrahja dhe Ilogaridhënia ndaj Kuvendit

Me qëllim të rritjes së llogaridhënieve në institucionet publike dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit, ZKA do të ofroj gjithë përkrahjen e nevojshme për Kuvendin dhe do të përbush plotësisht obligimet e saj kushtetuese e ligore ndaj Kuvendit.

ZKA do të vazhdoj me përgatitjen e përbledhjeve të raporteve individuale të auditimit për nevoja të komisioneve parlamentare, si dhe do të intensifikoj pjesëmarrjen në takimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe do të ofroj këshilla dhe sqarime të nevojshme për anëtarët e komisioneve të Kuvendit për çështjet e evidentuara në raportet e auditimit.¹ Për qëllime të koordinimit më të mirë, ZKA ka caktuar një zyrtar ndërlidhës me Kuvendin dhe komisionet përkatëse parlamentare. Për më tepër ZKA do të koordinoj aktivitetet edhe me donatorët që ofrojnë asistencë teknike dhe përkrahje profesionale për Kuvendin dhe organet e tij.

Ashtu siç kërkohet me Ligjin e ZKA-së, brenda afatit ligor, Auditori i Përgjithshëm do t’ia dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës rreth aktivitetave të Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe do të bashkëpunoj ngushtë me auditorët e pavarur që do të kryejnë auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të ZKA-së.

Po ashtu, në përputhje me Ligjin e ZKA-së, Auditori i Përgjithshëm do të prezantoj edhe kët vit Raportin vjetor të auditimit, në seancë plenare të Kuvendit.

1.2 Përkrahja për reformat në Menaxhimin e Financave Publike

Zyrtarët e ZKA-së kanë marrë pjesë aktive në grupin punues për “Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike” në të cilin janë të përfshirë të gjithë aktorët e rëndësishëm të fushës si dhe donatorët. ZKA do të vazhdojë të ofrojë përkrahjen e saj për aktivitetet e parapara në kuadër të Strategjisë, që synojnë rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit dhe rrjedhimisht rritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve në shpenzimin e parasë publike dhe avancimin e qeverisjes në institucionet publike.

1.3 Obligimet e ZKA-së me Marrëveshjen për Stabilizim Asociim

Me planin e punës së ZKA janë paraparë edhe aktivitete që fokusohen në zbatimin e prioriteteve kryesore që ndërlidhen me Kapitullin 32 (Kontrolli financiar) të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA) që kanë për qëllim fuqizimin e llogaridhënieve, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe entiteteve të sektorit publik.

¹ Gjatë vitit 2016 kemi përkrahur KMFP të Kuvendit të Kosovës në shqyrtimin e 14 raporteve të auditimit. Kjo përkrahje është dhënë përmes përgatitjes së përbledhjeve dhe ofrimit të sqarimeve në takime përgatitore. Si rezultat i këtyre shqyrtimeve KMFP ka nxjerrë 9 rekomandime specifike për OB-të lidhur me këto raporte.

2. OBJEKTIVAT E ZKA-së

Objektivi parësor i ZKA-së është që t'i siguroj taksapaguesit dhe donatorët ndërkombe të nëse fondet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Ne do ta bëjmë këtë duke siguruar që fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrë të matur dhe siç duhet. ZKA do të ndihmoj në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe Menaxhimin e Financave Publike si dhe do të jap kontributin për zhvillimin e mëtejshëm të administratës publike.

Objektivat specifike të ZKA-së për sezonin auditues 2017/18 janë:

2.1 Aktivitetet audituese

- Kryerja e mbi 100 auditimeve:
 - Auditimi i Raportit Vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës;
 - Përfshirja e të gjitha organizatave buxhetore në auditimet e detyrueshme të rregullsisë;
 - Dyfishimi i numrit të auditimeve të Ndërmarrjeve publike, në krahasim me vitin paraprak;
 - Rritja e numrit të auditimeve të performancës;
 - Zhvillimi i mëtejshëm i auditimeve të teknologjisë informative;
 - Auditimi i projekteve që financohen nga huamarrja shtetërore; dhe
 - Auditimi i projekteve që financohen nga donatorët (sipas kërkesës).

2.2 Korniza ligjore, standardec dhe zhvillimi korporativ dhe profesional

- Rishikimi i Planit për Zhvillimin Korporativ, përfshirë hartimin e Planit Strategjik të Auditimit;
- Propozimi për ndryshimin – plotësimin e legjislacionit themelor që definon veprimtarinë e ZKA-së si dhe kompletimi i legjislacionit sekondar në pajtim me Ligjin e ZKA-së dhe zbatimi i udhëzuesve të brendshëm që burojnë nga legjislacioni i ri;
- Ngritura dhe forcimi i mëtejshmë i kapaciteteve të brendshme administrative dhe menaxhimi efikas i ndryshimeve organizative;
- Zbatimi i planit të trajnimeve specifike, përfshirë aktivitetet që kanë për qëllim edukimin e vazhdueshëm profesional (certifikimi i auditorëve);

- Përcjellja dhe zbatimi i standardeve të reja me qëllim të ruajtjes së konsistencës dhe zhvillimit të auditimeve në pajtim me Standardet Ndërkomëtare të Auditimit të Sektorit Publik;
- Rishikimi i doracakëve për auditime të rregullsisë dhe të performancës si dhe azhurnimi i Udhëzuesit për Kontrollin e Cilësisë dhe të pakove të letrave të pumës;
- Përmirësimi i mëtejmë i cilësisë, përmes kontolleve të shtuara me rastin e hartimit të planeve dhe programeve të auditimit dhe rishikimit të raporteve individuale të auditimit si dhe Raportit Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës.

2.3 Bashkëpunimi dhe kultivimi i marrëdhënieve me palët e interesit në Kosovë dhe organizatat ndërkomëtare

- Thellimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile (SHC), me synim themelin e një Forumi konsultativ;
- Thellimi i bashkëpunimit me organizatat partnere dhe donatore: gjatë sezonit auditues 2017/18, ZKA do të vazhdoj bashkëpunimin me institucione dhe organizata të ndryshme në fushat e ndërlidhura me auditimin apo zhvillimin profesional. Në këtë kuadër do të vazhdohet bashkëpunimi me ISA-të partnere, veçanërisht, Zyren Kombëtare të Suedisë (Projekti i bashkëpunimit bilateral); Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë (Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga Bashkimi Evropian); Bankën Botërore (projekti “Fuqizimi i kapaciteteve të ZKA-së në auditimet e prokurimit”); USAID (Projekti “Komuna transparente, efektive dhe të përgjegjshme - TEAM”); GIZ (Projekti “Reformimi i financave publike të Kosovës”); Zyren Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (Projekti “Decentralizimi dhe përkrahja komunale – DEMOS”); OSBE për organizimin e punëtorive rajonale për diskutimin e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit për vitin 2016 për komunat e Kosovës;
- Intensifikimi i bashkëpunimit bilateral me ISA-të: të Suedisë, të Uellsit, të Shqipërisë, etj;
- Pjesëmarrja në aktivitetet e organizatave profesionale të institucioneve supreme të auditimit ndërkomëtare e rajonale të ISA-ve: Organizatën Ndërkomëtare të ISA-ve (ONISA); Organizatën Evropiane të ISA-ve (EUROSAI); Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA); Institucionin Suprem të Auditimit Amerikan (GAO); Komitetin e Kontaktit (ISA-të e vendeve anëtare të BE-së), Rrjetin e ISA-ve të vendeve kandidate dhe atyre potencialisht kandidate të BE-së, etj.

Përshkrimet më të hollësishme për aktivitetet në kuadër të objektivave të mësipërmje janë dhënë në kapitujt 5 dhe 7 të këtij dokumenti.

3. LLOJET E AUDITIMEVE

Në përputhje me fushëveprimin e vet, gjatë sezonit 2017/18, ZKA do të kryej dy lloje të auditimeve:

- Auditime të rregullsisë** të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin akrual).
- Auditime të performancës**, përfshirë auditimet e projekteve të finançuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, sipas kërkesës.

3.1 Auditimet e rregullsisë: përfshijnë auditimin e PFV-ve dhe llogarive kryesore të institucionit të audituar, me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe llogaritë pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit finanziar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Këto auditime kryhen çdo vit dhe raportohen në një afat të caktuar kohor. Auditimet fillojnë në shtator, memot e auditimit dorëzohen tek entitete në dhjetor ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

ZKA-ja do të kryej edhe auditimeve të rregullsisë në ndërmarrjet publike, bazuar në sistemin akrual.

3.2 Auditimet e performancës: paraqesin një ekzaminim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektiviteti (përbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Këto auditime përfshijnë tema të ndryshme në fushën e arsimit, shëndetësisë, prokurimit, infrastrukturës, social ekonomike, teknologjisë informative. Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Ky auditim ndërlidhet me atë që njihet si koncepti i tri E-ve: ekonomiciteti, efikasiteti dhe efektiviteti. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA ndjek njërin nga tri qasjet:

- qasjen e orientuar në *resultate*, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në *problem*, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit(ve); ose

- qasjen e orientuar në *sistem*, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.

ZKA do të kryej poashtu edhe auditime të projekteve të finançuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombejtare, në bazë të marrëveshjes me donatorët dhe/ose përfituesit e tyre. Për këto auditime ZKA aplikon një tarifë, ndërsa fondet e inkasuara derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Për sezonin auditues 2017/18, ZKA ka planifikuar të kryej edhe **auditime të teknologjisë informative**.

Përmes auditimeve dhe aktivitetave tjera këshilluese, ZKA e mbështet llogaridhënien dhe transparencën e organizatave të audituara në përdorimin e parasë publike, pajtueshmërinë me kërkosat ligjore, qeverisjen e mirë, arritjen e vlerës për para si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

4. PROCESI I AUDITIMIT

4.1 Procesi i auditimeve të rregullsisë edhe këtë sezonë bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Rregullsisë dhe standardet ndërkombejtare të auditimit për sektorin publik. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa fazë duke filluar nga:

- njojja e entitetit dhe analiza e reziqeve;
- planifikimi i auditimit;
- ekzekutimi i auditimit (të ndërmjetëm dhe final);
- dhënia e konkluzioneve të auditimit;
- raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Procesi i auditimit të rregullsisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim, i cili ka përgjegjësinë të siguroj që auditimet janë kryer duke u bazuar në standardet ndërkombejtare të auditimit për sektorin publik nga faza e planifikimit deri në fazën e ekzekutimit dhe raportimit.

4.2 Procesi i auditimeve të performancës bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe standardet ndërkombejtare të auditimit për sektorin publik. Auditimi i perfomancës kryhet nëpër disa fazë, duke filluar nga:

Faza I. Propozimi i temave për auditim. Në këtë fazë bëhet propozimi i temave të mundshme për auditim. Të gjitha propozimet konsiderohen nëpërmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar.

Faza II. Përgatitja e memos parastudimore. Në këtë fazë tema audituese veçse është përcaktuar dhe ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rrëth temës përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.

Faza III. Ekzekutimi i punës në terren. Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren.

Faza IV. Raportimi. Me të përfunduar punën në terren ekipi auditues shkruan raportin e auditimit. Raporti duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj.; dhe

Faza V. Përcjellja e auditimit. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellës vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

5. PLANI VJETOR I AUDITIMIT DHE ORGANIZIMI

Për sezonën e auditimit 2017/18 janë përfshirë të gjitha auditimet e detyrueshme të rregullsisë të përcaktuara me nenin 18.3 të Ligjit të ZKA-së. Poashtu, në përbushje të kërkesave të përcaktuara ligjore është përfshirë një numër më i madh i auditimeve të rregullsisë të ndërmarrjeve publike dhe auditimeve të përfomancës, krahasuar me sezonën e kaluar.

Në përputhje me Planin vjetor të auditimit për sezonin e auditimit 2017/18 dhe në mbështetje të nenit 10 të Ligjit të ZKA-së, është bërë riorganizimi i njësive organizative të ZKA-së që merren me punët audituese. Gjatë këtij sezioni, ZKA do të ketë 5 Divizione audituese, përfshirë Divisionin për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim dhe 17 departamente të auditimit, të cilat do të kryejnë gjithsej 121 auditime:

- 1 auditim për Raportin Vjetor të Buxhetit të Kosovës;
- 24 auditime të rregullsisë së institucioneve të nivelit qendror;
- 30 auditime të rregullsisë së institucioneve të pavarura;
- 38 auditime të rregullsisë së komunave;
- 9 auditime të rregullsisë së ndërmarrjeve publike;
- 13 auditime të përfomancës; dhe
- 6 auditime të prokurimeve/projekteve.

Auditori i Përgjithshëm mund të autorizojë edhe auditime tjera, sipas nevojës dhe në varësi të burimeve financiare e njerëzore, të cilat do të shtohen në shtojcë të këtij plani.

Raportet për auditimet e rregullsisë do të finalizohen deri më 30 Qershori 2018, përvèç Raportit Vjetor të Buxhetit të Kosovës i cili dorëzohet në Kuvendin e Kosovës jo më vonë se 31 gusht 2018. Ndërsa auditimet e përfomancës dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm, për çdo sezonë auditimi.

Në vazhdim është dhënë një përshkrim i planit të auditimit dhe angazhimit të strukturave organizative të ZKA-së në procesin e auditimit.

5.1 DIVIZIONI I INSTITUCIONEVE QENDRORE

Divizioni për auditimin e Institucioneve Qendrore udhëhiqet nga një Ndihmës Auditor dhe përbëhet nga 4 Departamente:

1. Departamenti për Ekonomi – 3 ekipe dhe 9 entitete;
2. Departamenti për Arsim dhe Shëndetësi – 2 ekipe dhe 5 entitete; dhe
3. Departamenti për Drejtësi, Siguri dhe Punë të jashtme – 2 ekipe dhe 6 entitete;
4. Departamenti për Planifikim, Bujqësi dhe Mirëqenie – 2 ekipe dhe 4 entitete.

Ky Divizion do të ketë gjithsej 32 punonjës (përfshirë Ndihmës AP dhe Udhëheqësit e Departamenteve), të organizuar në 9 ekipe, të cilët do të kryejnë 24 auditime të rregullsissë. Ky Divizion do të kryej edhe auditime të projekteve, sipas marrëveshjes me entitetet kërkuese.

Entitet që do të auditohen nga ky Divizion janë paraqitur në Tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1: Entitet që do të auditohen nga Divizioni i Institucioneve Qendrore

Entitetet nën auditim	
1	Ministria e Financave
2	Administrata Tatimore e Kosovës
3	Dogana e Kosovës
4	Zyra e Kryeministratit
5	Ministria e Infrastrukturës
6	Ministria e Administratës Publike
7	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
8	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
9	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
10	Universiteti i Prishtinës
11	Ministria e për Komunitete dhe Kthim
12	Ministria e Shëndetësisë
13	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës
14	Ministria e Punëve të Brendshme
15	Ministria e Punëve të Jashtme
16	Ministria e Integrimeve Evropiane
17	Ministria e Drejtësisë
18	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
19	Ministria e Diasporës
20	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
21	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
22	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
23	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
24	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ²

² Auditimin do ta kryej firma audituese Deloitte.

5.2 DIVIZIONI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA DHE NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Divizioni për auditimin e Institucioneve të Pavarura dhe Ndërmarrjeve Publike udhëhiqet nga një Ndihmës Auditor dhe përbëhet nga 3 Departamente:

1. Departamenti 1 për Institucione të Pavaruara – 3 ekipe dhe 15 entitete;
2. Departamenti 2 për Institucione të Pavaruar – 3 ekipe dhe 15 entitete; dhe
3. Departamenti për Ndërmarije Publike – 3 ekipe dhe 9 entitete.

Ky Divizion do të ketë gjithsej 31 punonjës (përfshirë Ndihmës AP dhe Udhëheqësit e Departamenteve), të organizuar në 9 ekipe, të cilët do të kryejnë 39 auditime të rregullsisë.

Për sezonin auditues 2017/18 janë përfshirë në Planin e auditimit 9 Ndërmarrje Publike (NP). Dy prej NP-ve do të auditohen nga ZKA për vitin e dytë me radhë, ndërkaq 7 NP do të auditohen për herë të parë nga ZKA. Përzgjedhja e tyre kryesisht është diktuar nga gjendja e kontraktimave të NP-ve për shërbimet e auditimit të jashtëm sepse një numër i NP-ve kanë kontrata për auditimin e PFV-ve të tyre edhe për vitet në vijim. Poashtu, është marr në konsideratë mbulueshmëria në tri nivele të organizimit, NP-të e nivelit qendror, rajonal dhe lokal, si dhe mbulueshmëria rajonale.

Entitet që do të auditohen nga Divizioni për Institucione të Pavarura dhe NP-ve janë paraqitur në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2: Entitet që do të auditohen nga Divizioni i Institucioneve të Pavarura dhe NP-ve

Entitetet nën auditim	
1	Zyra e Presidentit
2	Gjykata Kushtetuese e Kosovës
3	Komisioni i Pavarur i Mediave
4	Agjencia Kundër Korrupsionit
5	Akademia për Drejtësi (Instituti Gjyqësor i Kosovës)
6	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
7	Këshilli Prokurorial i Kosovës
8	Institucioni i Avokatit të Popullit
9	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
10	Organi Shqyrtares i Prokurimit
11	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
12	Agjencioni për Shërbime të Navigimit Ajror
13	Akademia e Shkencave dhe e Arteve
14	Autoriteti i Aviacionit Civil
15	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
16	Administrata e Kuvendit
17	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

18	Zyra e Rregullatorit për Energji
19	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
20	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
21	Agjencia Kosovare e Privatizimit
22	Fondi i Privatizimit
23	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
24	Autoriteti Rregulator për Shërbimet e Ujit
25	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
26	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim
27	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë
28	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
29	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
30	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
31	Trainkos
32	Hortikultura Prishtinë
33	KUR Drini i Bardhë
34	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
35	KUR Hidroregjioni Jugor
36	Stacioni i Autobusëve – Prishtinë
37	Aeroporti i Gjakovës
38	KRM Uniteti
39	KUR Prishtina

5.3 DIVIZIONI I KOMUNAVE

Divizioni për Auditimin e Komunave udhëhiqet nga një Ndihmës Auditor dhe përbëhet nga 4 Departamente. Komunat janë ndarë në departamente kryesisht sipas shtrirjes gjeografike:

1. Departamenti Qendër/Veri – 3 ekipe dhe 10 entitete;
2. Departamenti Jug – 4 ekipe dhe 10 entitete;
3. Departamenti Lindje – 3 ekipe dhe 9 entitete; dhe
4. Departamenti Perëndim – 3 ekipe dhe 9 entitete.

Ky Divizion do të ketë gjithsej 38 punonjës (përfshirë Ndihmës AP dhe Udhëheqësit e Departamenteve), të organizuar në 13 ekipe, të cilët do të kryejnë 38 auditime të rregullsisë.

Entitet që do të auditohen nga ky Divizion janë paraqitur në Tabelën 3 më poshtë.

Tabela 3: Entitet që do të auditohen nga Divizioni i komunave

	Entitetet nën auditim
1	Prishtinë
2	Obiliq

3	Podujevë
4	Fushë Kosovë
5	Mitrovica e Jugut
6	Graçanicë
7	Mitrovica e Veriut
8	Leposaviq
9	Zubin Potok
10	Zveçan
11	Dragash
12	Prizren
13	Mamusha
14	Malishevë
15	Rahovec
16	Lipjan
17	Shtime
18	Suharekë
19	Shtërpçë
20	Kllokot
21	Kamenicë
22	Gjilan
23	Viti
24	Novobërdë
25	Partesh
26	Ranillug
27	Kaçanik
28	Hani i Elezit
29	Ferizaj
30	Klinë
31	Pejë
32	Istog
33	Glllogoc
34	Skenderaj
35	Vushtrri
36	Gjakovë
37	Junik
38	Deçan

5.4 DIVIZIONI I PERFORMANCES, PROKURIMIT DHE PROJEKTEVE

Divizioni për auditime të Performancës, Prokurimit dhe Projekteve udhëhiqet nga një Ndihmës Auditor dhe përbëhet nga dy departamente:

1. Departamenti për Auditim të Performancës – 9 ekipe dhe 13 tema; dhe
2. Departamenti për Auditim të Prokurimit dhe Projekteve – 4 ekipe dhe 6 tema.

Ky Divizion do të ketë gjithsej 18 punonjës (përfshirë Ndihmës AP dhe Udhëheqësit e Departamenteve), të organizuar në 13 ekipe, të cilët do të kryejnë 19 auditime të performancës.

Përcaktimi i prioriteteve për të kryer auditimet e performancës është bërë duke marr parasysh aspektin material, financiar dhe ndikimin në jetën dhe mirëqenien e qytetarëve. Temat e auditimit të performances janë përgjedhur duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të parapara me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si: shtimi i vlerës tek programet dhe aktivitetet qeveritare, programet apo aktivitetet të cilat bartin kosto materiale dhe janë në interes të publikut, vlerësimi i fushave me rrezik si dhe fushave me ndikim strategjik në jetën e qytetarëve. Po ashtu, janë marr në konsideratë edhe kapacitetet e burimeve njerëzore të ZKA-së dhe afatet kohore për realizimin e tyre.

Për përcaktimin e temave për auditime të performancës janë marr parasysh edhe propozimet dhe sugjerimet nga disa palë të interesit, si: (i) Kuvendi, gjegjësisht Komisionet parlamentare; (ii) Shoqëria civile, OJQ-të, Akademia, etj; dhe (iii) departamentet brenda ZKA-së. Për të siguruar që temat e përgjedhura për auditim të performances për sezonin auditues 2017/2018 janë me interes publik dhe ndikojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënieς, ZKA ka organizuar një tryezë pune me organizatat e Shoqërisë Civile, ku janë diskutuar temat me interes për auditim të performancës të identikuara nga ekipet audituese të ZKA-së si dhe propozimet nga shoqëria civile.

Raportet e auditimit të performancës, për dallim nga ato të rregullsisë, nuk kanë ndonjë afat të caktuar ligjor për publikim dhe ato bëhen publike sipas planit vjetor të auditimit të ZKA-së.

Temat që do të auditohen nga ky Divizion janë paraqitur në Tabelën 4 më poshtë.

Tabela 4: Temat që do të auditohen nga Divizioni i Performancës, Prokurimit dhe Projekteve

Temat nën auditim	
1	Sistematizimi i të pastrehëve në banesat kolektive
2	Politikat qeveritare në hapjen e vendeve të reja të punës
3	Sistemi Informativ i Integruar i Policisë së Kosovës
4	Sistemi i Tatimit në Pronë
5	Auditimi Përcjellës – Menaxhimi i Pajisjeve Mjekësore
6	Radio Televizioni i Kosovës
7	Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivelin lokal
8	Vlerësimi i sistemeve të TI-së në nivel lokal dhe qendror
9	Sistemi Informativ Shëndetësor
10	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
11	Menaxhimi i sistemit e-pasuria
12	Cilësia e Ajrit
13	Efikasiteti në menaxhimin e lëndëve në gjykata

14	Prokurimet e Centralizuara
15	Procedura me negocim pa publikim të njoftimit për kontratë
16	Menaxhimi i kontratave të prokurimit
17	Menaxhimi i barnave mijekësore
18	Bashkëfinancimet
19	Marrëveshjet për Shërbime të Vecanta

5.5 DIVIZIONI PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË AUDITIM

Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim udhëhiqet nga një Ndihmës Auditor dhe përbëhet nga 4 Departamente.

1. Departamenti për Metodologji, Standarde dhe Zhvillim;
2. Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim;
3. Departamenti Ligjor në Auditim; dhe
4. Departamenti për Analiza dhe Auditim të Buxhetit të Kosovës.

Numri i përgjithshëm i personelit (përfshirë Ndihmës AP dhe Udhëheqësit e Departamenteve) është 13.

Cilësia në auditim është kërkesë ligjore dhe e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Puna e njësive organizative në kuadër të Divisionit për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim fokusohet në aktivitete të caktuara për krijimin e kushteve për kryerjen e punëve audituese me cilësinë e duhur si dhe në zbatimin e mekanizmave të përcaktuar për kontrollin e cilësisë në gjithë procesin e auditimit.

Aktivitetet themelore të këtij Divizioni gjatë këtij sezioni do të fokusohen në:

- hartimin dhe përditësimin e doracakëve të auditimit, letrave të punës, përcjelljen dhe prezantimin e ndyshimeve në SNA, ofrimin e mbështetjes profesionale për auditorët, identifikimin e nevojave për trajnime dhe ofrimin e tyre;
- rishikimin e procesit të auditimit në të gjitha fazat dhe zbatimin e kontrollit të cilësisë në auditim sipas një plani të veçantë të punës;
- analizimin e të dhënave të caktuara dhe përpunimin e tyre për qëllime të auditimit dhe koordinimi i aktiviteteve për auditimin e Buxhetit të Kosovës; dhe
- hartimin e dokumenteve të natyrës ligjore, dhëni e këshillave dhe opinioneve ligjore me qëllim të arritjes së sigurisë në çështjet e auditimit dhe lidhur me auditimin.

5.5.1 Aktivitetet e vecanta në fushën ligjore nga Departamenti Ligjor në Auditim

Gjatë zhvillimit të punës audituese në sezonën 2016/17 kemi identifikuar mangësi dhe rregullime kolizive në disa akte ligjore me të cilat lidhet drejtpërdrejtë puna audituese e ZKA-së. Gjatë sezonit në vijim, planifikojmë paraqitjen e propozimeve në organet përkatëse për inicimin e ndryshimeve – plotësimeve të këtyre akteve ligjore:

1. Propozimi për ndryshimin – plotësimin e Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

2. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe dhënia e kontributit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës me qëllim të evitimit të kolizioneve ligjore lidhur me raportimin financiar të NP-ve.
3. Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore për menaxhimin e subvencioneve.

Arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore do të paraqiten në propozimet iniciuese drejtuar organeve kompetente.

Në kuadër të aktiviteteve të brendshme ligjore të Zyrës Kombëtare të Auditimit, planifikojmë vazhdimin e punës në plotësimin e kornizës së akteve nënligjore dhe të doracakëve të auditimit në zbatim të Ligjit të ZKA-së, akteve të tjera në fuqi dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Gjatë kësaj periudhe, por pa u kufizuar vetëm në këtë, planifikojmë hartimin e këtyre akteve: Rregulloren për Administrimin e Dokumenteve në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Rregulloren për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Rezultateve në Punë; Klasifikimin e dokumenteve zyrtare; dhe Hartimin e doracakëve përfushat e pambuluara të auditimit dhe përditësimi i doracakëve të tjerë në përdorim për auditime të rregullsisë dhe auditime të përfomancës.

5.5.2 Bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë

Auditori i Përgjithshëm dhe personeli i ZKA-së do të vazhdojë bashkëpunimin ndër-institucional me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse përfshirë luftimin e korruptionit. Në këtë kuadër do të koordinohen veprimet lidhur me detyrimet e përaktuara ligjore me: **Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit**, duke e informuar në lidhje me rastet indikative me elemente të veprave penale të cilat hasen gjatë punës audituese; **Agjencinë Kundër Korruptionit**, duke i ofruar informata shtesë dhe sqarime sipas nevojës lidhur me trajtimin e të gjeturave në raportet e auditimit; **Njësinë për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës**, duke i ofruar të dhëna dhe dokumente relevante të siguruara në proceset e auditimit përfshirë rastet e caktuara të cilat trajtohen nga hetuesia.

Në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse përfshirë luftimin e korruptionit, ZKA-ja, vepron në përpunhje të plotë me standartet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale.

6. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

Burimi i vetëm i financimit të veprimtarisë së ZKA-së është Buxheti i Republikës së Kosovës. Miratimi i buxhetit është kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në këkesën buxhetore të ZKA-së.

ZKA ka marrëveshje bashkëpunimi me disa organizata homologe dhe partnerë ndërkombe të. Aktivitetet e parapara në kuadër të këtij bashkëpunimi do të mbështeten kryesisht nga partnerët e ZKA-së.

6.1. Buxheti

Buxheti i ZKA-së për vitin 2017, i miratuar me Ligjin nr. 05/L-125, është 2,397,794 €. Në përbushje të kërkesave ligjore për auditimin e detyrueshëm të rregullsisë të gjitha organizatave buxhetore, duke përfshirë edhe auditimin e NP-ve si dhe rritjen e numrit të auditimeve të performancës, janë rritur edhe shpenzimet operative, administrative, të mirëmbajtjes së objekteve dhe shpenzimet e komunalive. Buxheti në disa nënkategori ekonomike nuk është i mjaftueshëm për të realizuar planin e auditimit sipas dinamikës së paraparë, prandaj ZKA ka bërë kërkesë përmjet shtesë në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2017.

Planifikimi dhe kërkesa buxhetore për vitin 2018 ndërlidhet drejtpërdrejtë me nevojat përmbrushjen e veprimit të audituese të përcaktuar për sezonën e auditimit 2017/18 dhe me vazhdimin e rritjes së vëllimit të aktiviteteve audituese për sezonën e auditimit 2018/19. Ndërlidhur me këtë është e domosdoshme rritja e kapaciteteve njerëzore, prandaj në kërkesën buxhetore janë përfshirë edhe 10 vende të reja të punës në fushën e auditimit. Kërkesa buxhetore ndërlidhet edhe me realizimin e objektivave të tjera, sidomos me ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve dhe me synimin e ZKA-së për anëtarësim në organizatat ndërkombe të rajonale të institucioneve supreme të auditimit. Kërkesa buxhetore e ZKA-së për vitin 2018 është 2,853,953€.

6.2 Burimet njerëzore dhe trajnimet

Për vitin 2017, sipas Ligjit të Buxhetit, ZKA ka të miratuara 160 vende pune. Aktualisht rreth 130 punonjës janë të angazhuar drejtpërdrejtë në auditim (auditorë), ndërsa pjesa tjetër janë të punësuar në shërbimet administrative. Struktura kualifikuese e auditorëve është e kënaqshme dhe me tendencë të përmirësimit të vazhdueshëm. Rreth 70 auditorë janë të certifikuar në njëren apo në të dy skemat për auditor të sektorit publik dhe auditor të sektorit privat. Të tjerët janë në proces të certifikimit në nivele të caktuara të skemave përkatëse.

Me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike, përvèç kualifikimeve profesionale në certifikim për auditim dhe kontabilitet, ZKA investon në zhvillim profesional të kapaciteteve njerëzore, ku përmes ngritjes së vazhdueshme profesionale të punonjësve dhe ndërtimit të karrierës në ZKA, synojmë të forcjmë kompetencën profesionale të tyre. Ndërlidhur me këtë, ZKA përbushë normativin vjetor të përcaktuar me SNISA për arsimin e vazhdueshëm profesional si një nga parakushtet themelore përsigurimin e cilësisë në auditim. Për këtë qëllim, ZKA harton planin vjetor të trajnimeve që përfshinë trajnime nga ekspertët e ZKA-së dhe ekspertë të jashtëm. Në këtë plan inkorporohen edhe aktivitetet e trajnimeve të parapara në kuadër të projekteve me partnerët dhe donatorët e jashtëm, brenda dhe jashtë vendit.

7. BASHKËPUNIMI DHE PROJEKTET

Gjatë sezonit auditues 2017/18, bazuar në mandatin kushtetues e ligjor, ZKA do të bashkëpunoj me institucione dhe organizata të ndryshme në fushat e ndërlidhura me auditimin apo zhvillimin profesional. Në vazhdim janë paraqitur informatat themelore në lidhje më këto bashkëpunime dhe projekte.

7.1 Projekti i bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Suedisë (SNAO)

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës dhe Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO) kanë filluar bashkëpunimin e tyre që nga viti 2011, ndërkaq nga viti 2013 ky bashkëpunim është intensifikuar dhe zgjeruar. Marrëveshja paraprake ka përfunduar më 30 qershori 2017.

Marrëveshja e re e bashkëpunimit do të zbatohet gjatë tri viteve të ardhshme, përkatësisht gjatë periudhës korrik 2017 – qershori 2020 dhe ka për qëllim fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të ZKA-së. Marrëveshja përfshinë bashkëpunimin për zhvillimin profesional në fushat në vijim: *Menaxhment, Auditime të Performancës, Menaxhim të Burimeve Njerëzore, Auditime të Rregullsisë, Planifikim Strategik dhe Komunikim*.

Bashkëpunimi mund të zgjerohet edhe në fusha të tjera që kanë për qëllim zhvillimin institucional të ZKA-së në pajtim më Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të këtij bashkëpunimi bëhet në bazë të planeve vjetore që aprovohen nga Komiteti drejtues i Projektit, ndërkaq financimi i misioneve të ekspertëve për trajnime dhe mentorim do të bëhet nga SNAO.

7.2 Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga Bashkimi Evropian

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është zhvillimi i një qasjeje të përgjithshme të auditimit në lidhje me kontabilitetin akrual dhe hartimi i dokumenteve përkatëse që kanë të bëjnë me auditimin e ndërmarrjeve publike duke avancuar shkathësitë dhe kapacitetet e ZKA-së për auditimin e NP-ve në Kosovë. Projekti do të zbatohet nga ISA i Polonisë dhe do të përkrahë drejtpërdrejt Departamentin e auditimit të NP-ve dhe Divisionin për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit në ZKA.

Projekti pritet të filloj në shtator 2017 dhe do të zgjasë gjashtë muaj. Aktivitetet në kuadër të projektit janë ndarë në dy komponente që përfshijnë: (i) *Zhvillimi i qasjes dhe metodologjisë së auditimit të NP-ve dhe (ii) Përkrahja për Divisionin për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit (DMCA) dhe Departamentin për Auditimin e NP-ve*. Projekti përfshinë edhe aktivitete trajnimi dhe mentorimi.

7.3 Projekti i financuar nga Banka Botërore

Projekti i Bankës Botërore “*Fuqizimi i kapaciteteve të ZKA-së në auditimet e prokurimit*” ka për qëllim ofrimin e përkrahjes në fuqizimin e kapaciteteve të ZKA-së në auditimet e vlerës për para

dhe auditimet e pajtueshmërisë në fushën e prokurimit. Projekti përfshinë aktivitetet në vijim: (i) *Rishikimi dhe analizimi i dokumenteve kryesore në fushën e prokurimit*; (ii) *Azhurnimi i dokumenteve relevante dhe mentorimi i auditimeve me fokus në Vlerën për Para në Prokurim*; (iii) *Trajnime dhe auditime pilot me fokus në Auditimet e Pajtueshmërisë; si dhe* (iv) *Punëtori për shkëmbimin e njohurive rajonale*.

Projekti pritet të fillojë së zbatuari në tremujorin e fundit të vitit 2017 dhe do të zgjasë 18 muaj.

7.4 Bashkëpunimi me USAID

ZKA do të vazhdoj bashkëpunimin me USAID në kuadër të projektit “*Komuna transparente, efektive dhe të përgjegjishme - TEAM*”. TEAM është një projekt 5 vjeçar i financuar nga USAID në Kosovë që ka filluar në janar 2017 dhe është planifikuar të përfundoj në janar të vitit 2022. Projekti është dizajnuar për të përmirësuar procesin e prokurimit, transparencën dhe mbikëqyrjen nëpërmjet ofrimit të asistencës gjithëpërfshirëse për 38 komuna të Kosovës për të përmirësuar llogaridhëni përfundimtarët dhe shpenzimet publike.

Në nivel qendror, TEAM do të ofrojë mbështetje për përpjekjet komunale kundër korruzionit, duke punuar ngushtë me një sërë aktorësh të nivelit kombëtar, përfshirë Zyren Kombëtare të Auditimit. Projekti do të ndihmojë ZKA-në në zhvillimin e kapaciteteve në fushat e zbulimit të mashtrimit në nivel të qeverisjes lokale dhe zbulimin e mashtrimit në fushën e prokurimit në qeverisjen qendrore. Në veçanti, qëllimi i aktivitetit është rritja e aftësisë së Divizionit për Auditimin e Komunave dhe Departementit për Auditime të Performancës në ZKA në fushën e zbulimit të mashtrimit në mënyrë që raportet e auditimit të prodhojnë në mënyrë më efektive dobësitë sistematike të shënuara në procesin e prokurimeve ku mund të ndodhë korruzioni.

7.5 Bashkëpunimi me GIZ

ZKA do të vazhdoj bashkëpunimin me GIZ në kuadër të projektit “*Reformimi i financave publike të Kosovës*”, që paraqet fazën e tretë të përkrahjes teknike për Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës. Bashkëpunimi me GIZ do të fokusohet sidomos në kuadër të aktiviteteve që parashihen me Kuvendin e Kosovës përkatësisht Komitetin për Buxhet dhe Financa dhe Komitetin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë planifikuar aktivitete informuese dhe këshilluese për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe anëtarët e komisioneve të lartpërmendura përgjithësia e llogaridhënieve së administratës publike në Kosovë.

7.6 Bashkëpunimi me Zyren Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë

ZKA do të vazhdoj bashkëpunimin me Zyren Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë në kuadër të projektit “*Decentralizimi dhe përkrahja komunale – DEMOS*” që ka përfshirë përkrahjen përkohësish e komunat e Kosovës. Faza e dytë e projektit DEMOS pritet të fillojë zbatimin në janar të vitit 2018. Ky projekt planifikohet t'i mbulojë të gjitha komunat në Kosovë dhe synon të përmirësojë: i) qeverisjen demokratike komunale; ii) menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare të

komunave, si dhe iii) çështjet e rëndësishme të politikave lidhur me qeverisjen lokale. Projekti do të bashkëpunojë, përveç komunave edhe me ministritë përkatëse. Ndërsa, ZKA është veçanërisht e interesuar që përmes aktivitetetëve në kuadër të këtij Projekti të përmirësohet administrimi finansiar dhe transparenca, si dhe të rritet shkalla e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Me përkrahjen e projektit DEMOS, ZKA ka angazhuar këshilltarë për të ofruar mbështetje për Auditorin e Përgjithshëm dhe stafin auditues të ZKA-së në fushat: performancë institucionale, auditime të teknologjisë informative dhe auditime të performancës.

7.7 Bashkëpunimi me OSBE

Bashkëpunimi me Misionin në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për organizimin e punëtorive rajonale për diskutimin e rekomandimeve të raporteve të auditimit për komunat e Kosovës. Punëtoritë do të shërbejnë si forum për diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me performancën financiare dhe llogaridhënien e institucioneve komunale ndaj publikut, si dhe zbatimin e rekomandimeve të raporteve të auditimit, nga komunat.

7.8 Aktivitetet tjera të bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit

7.8.1 Bashkëpunimi bilateral me ISA-të

ZKA ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimin me ISA të Suedisë, të Uellsit dhe të Shqipërisë. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve do të zhvillohen aktivitetë të përbashkëta që kanë për qëllimin shkëmbimin e përvojave dhe ngritjen e mëtejme të kapaciteteve institucionale të ZKA-së.

ZKA do të vazhdoj bashkëpunimin e mirë edhe me ISA-të tjerë të rajonit, qoftë përmes auditimeve paralele apo aktivitetëve tjera të përbashkëta.

7.8.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare e rajonale të ISA-ve

Pas pjesëmarrjes në punimet e Kongreseve respektive të Organizatës Ndërkombëtare të ISA-ve – ONISA (INCOSAI 2016) dhe të Organizatës Evropiane të ISA-ve – EUROSASI (2017), ZKA do të vazhdoj me pjesëmarrjen aktive në aktivitetet që organizohen në kuadër të këtyre mekanizmave, si dhe do të vazhdoj të marr pjesë në aktivitetet e organzuara nga Gjykata Evropiane e Auditorëve (ECA), Komiteti i Kontaktit (ISA-të e vendeve anëtare të BE-së) si dhe Rrjeti i ISA-ve i vendeve kandidate dhe atyre potencialisht kandidate të BE-së, si dhe do të iniciohet bashkëpunimi me Institucionin Suprem të Auditimit Amerikan (GAO).


7.8.3 Bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Mediat

Do të vazhdohet me ciklin e takimeve periodike, por edhe sipas rastit, me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), që përfshinë: OJQ-të e fushës, shoqatat profesionale të auditimit e të kontabilitetit, universitetin publik, kolegjet private, mediat, etj. ZKA ka për synim ngritjen e këtij bashkëpunimi në nivel të një forumi konsultativ që do të shërbente për shkëmbimin e ideve dhe për ngritjen e iniciativave nga OSHC për përmirësimin e mëtejshëm të auditimit të jashtëm në Kosovë dhe për përkrahjen ZKA-së, sidomos për auditime të performancës.

8. ZBATIMI

Plani do të zbatohet nga 1 shtatori 2017 deri më 31 gusht 2018. Për zbatimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument ZKA do të përgatis plane të veçanta veprimi, sipas fushave dhe projekteve të caktuara.

Prishtinë, gusht 2017


Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm

